



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI**

URDHËR

Nr. 53, datë 9.4.2020

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR RISHIKIMIN
E STRATEGJISË KOMBËTARE TË DIASPORËS
DHE PLANIT TË VEPRIMIT**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të vendimit nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Diasporën 2018-2024 dhe të planit të veprimit”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe të planit të veprimit të saj, miratuar me vendimin nr.259, datë 9.5.2018, të Këshillit të Ministrave.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri i Shtetit për Diasporën dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për arsimin;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për financat;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për turizmin;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për punët e brendshme;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për drejtësinë;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë;



- Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse bujqësinë;
 - Përfaqësues i ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
 - Zëvendësministër në ministrinë përgjegjëse për kulturën;
 - Përfaqësues i Akademisë së Shkencave;
 - Titullari i INSTAT
 - Titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës
3. Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës mund të ftohen edhe ekspertë të fushave të tjera, si organizata jofitimprurëse, organizmat ndërkombëtarë, universitetet dhe personalitete të fushës.
 4. Propozimet e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e Strategjisë Kombëtare të Diasporës dhe planit të veprimit të saj të paraqiten për miratim në Këshillin e Ministrave brenda muajit qershor 2020.
 5. Ngarkohen titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, që brenda 5 (pesë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin ndërinstitucional të punës
 6. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, INSTAT-i, Akademia e Shkencave dhe Agjencia Kombëtare e Diasporës për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA